



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT**

N J O F T I M

**PËR KANDIDATËT APLIKANTË PËR PROVIMIN E SHTETIT NË PROFESIONET E
RREGULLUARA NË FUSHËN E MJEKËSISË SEZONI XXVII**

Për të gjithë kandidatët aplikantë për pjesëmarrje në provimin e shtetit në profesionin e rregulluar të Mjekut, Farmacistit, Stomatologut, Infermierit, Mamisë, Fizioterapistit, Logopedistit, Teknikut të Imazherisë dhe Teknikut të Laboratorit, ju bëjmë me dije se aplikimi do të kryhet online përgjatë periudhës **17 – 21 Shkurt 2025**, duke përdorur shërbimin “Aplikim për provim shteti” në platformën e-Albania. Provimi do të zhvillohet në godinën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë, ish-ATSH), sipas kalendarit i cili do të publikohet në vijim në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore www.qsha.gov.al.

Gjatë aplikimit online, kandidati duhet të ngarkojë dokumentet e mëposhtme:

- 1. Diplomën/diplomat e programit të studimeve për profesionin respektiv;*
- 2. Dëshminë e pjesëmarrjes dhe përfundimit me sukses të praktikës profesionale të lëshuar nga UP-ja ose në mungesë të UP-së, nga institucioni kompetent për kryerjen e praktikës, ku përcaktohet edhe kohëzgjatja;*
** Në raste të caktuara: Vërtetimin për njohjen dhe njësimin e diplomës në rast se studimet janë përfunduar jashtë shtetit; Dokumentacion të lëshuar nga institucioni përgjegjës për arkivat që provon lëshimin e diplomës apo dokumentit të barasvlershëm me të, të fituar nga institucioni i arsimit të lartë të mbyllur. Dokumenti që vërteton e vlefshmërinë e diplomës/diplomave të lëshuara.*
- 3. Vetëm pas njoftimit të pranimit nga Urdhri Profesional, faturën e pagesës së kryer për llogari të QSHA-së, e cila duhet të ngarkohet në sistem në fushën që shfaqet pas vendosjes së kodit të gjurmimit dhe kodit të sigurisë, **brenda 72 orëve nga njoftimi i pranimit nga Urdhri Profesional.***
Pas ngarkimit në sistem të pagesës, lutemi që kandidatët të qëndrojnë në pritje të email-it të pranimit nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.

Lidhur me aplikimin e shtetasve të huaj, pasi të zgjidhet shërbimi “Aplikim për provim shteti” në platformën e-Albania dhe opsioni “shtetas i huaj”, të plotësohen me kujdes fushat e kërkuara.

Kandidatët do të njoftohen në çdo fazë lidhur me statusin e aplikimit nëpërmjet postës elektronike, si dhe portalit e-Albania në rubrikën Hapësira ime – Mesazhet e mia.

****Për çdo problematikë lidhur me aplikimin, lutemi që kandidatët t’i drejtohen Urdhrave Profesionalë.***

1. Kandidati duhet të paraqitet pranë QSHA-së 30 minuta përpara orarit të publikuar dhe të jetë i pajisur me:

- Mjetin e identifikimit (Kartë ID ose Pasaportë, dokumenti origjinal);
- Faturën origjinale me vulën përkatëse, të pagesës së tarifës së provimit për llogari të QSHA, të kryer në një bankë të nivelit të dytë (sipas faturës për arkëtim të publikuar në faqen zyrtare të QSHA, <https://qsha.gov.al/fatura-per-arketim/>, bazuar në herën e pjesëmarrjes në provim);

Kandidatët, të cilët nuk paraqesin dokumentet e mësipërme, nuk do të mund të marrin pjesë në provim.

2. Kandidati gjatë zhvillimit të provimit duhet të zbatojë rregullat e mëposhtme:

- ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve apo mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
- ndalohet komunikimi me kandidatët e tjerë gjatë zhvillimit të provimit deri në marrjen e deklaratës së rezultatit;
- ndalohet lëvizja përtej vendit të përcaktuar për zhvillimin e provimit;
- ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit.

Orari i pjesëmarrjes në provim do të jetë i përcaktuar dhe nuk do të mund të ketë ndryshime.

Lutemi që kandidatët të verifikojnë paraprakisht të dhënat në listat emërore që do të publikohen në faqen zyrtare të QSHA-së www.qsha.gov.al dhe në rast pasaktësisht t'i drejtohen Urdhrave Profesionalë.

Ju urojmë Suksese!